



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nr. 3047/ 5 prot.**

**Datë 21/12/2023**

**V E N D I M**  
**Nr. 1348/2023**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 21/12/2023, shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:**

Modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit “*Procedurë e Hapur, e Thjeshtuar*”, me Nr. REF-89520-12-04-2023, me objekt: “*Blerje Kite dhe Reagentë, për nevojat e NJVKSH Tiranë*”, me fond limit 7.992.867 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 15.12.2023 nga autoriteti kontraktor, Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Tiranë.

**Ankimues:**

Operatori ekonomik “Avdul Gjoni” PERSON FIZIK me NIPT: M18929501J, me adresë: *Lagjia “Selam Musai”, Rruga “Dule Dalani”, ZK 3574, Nr. pasurie 56, godinë 1-katëshe, Tepelenë, Gjirokastër.*

**Autoriteti Kontraktor:**

Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Tiranë  
*Adresa: Rruga “Qamil Guranjaku”, Tiranë.*

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”  
Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë

19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## **Vëren:**

### **I**

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

### **II**

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 05.12.2023, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur, e Thjeshtuar”, me Nr. REF-89520-12-04-2023, me objekt:

“Blerje Kite dhe Reagentë, për nevojat e NJVKSH Tiranë”, me fond limit 7.992.867 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 15.12.2023 nga autoriteti kontraktor, Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Tiranë.

II.2. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datë 11.12.2023, operatori ekonomik “Avdul Gjoni” PERSON FIZIK ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe pranë autoritetit kontraktor, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

II.3. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Nëpërmjet shkresës nr. 3306/1 prot., datë 05.12.2023, protokolluar me tonën me nr. 3047/2 prot., datë 18.12.2023.2023, me objekt “Vendim në lidhje me Formularin e Ankesës të administruar pranë Autoritetit Kontraktor me nr. 3260 prot, datë 11.12.2023, nga OE “Avdul Gjoni” p.f”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik, vendimi i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “Avdul Gjoni” PERSON FIZIK për procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.5. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Avdul Gjoni” PERSON FIZIK dhe me vendimin nr. 3306/1 prot., datë 05.12.2023, ka vendosur mos pranimin e ankesës, me arsyetimet si më poshtë vijojnë:

[...]

*Për sa më sipër konstatohet në pikën 1, KSHA sqaron se sipas DST, informacioni i pasqyruar në 2.10 “Përshkrimi i shkurtër i kontratës / Marrëveshjes Kuadër”, të DST dhe informacioni i pasqyruar në 4.4 “Kriteret e përzgjedhjes së fituesit” tregojnë që vlerësimi i ofertave do të bëhet mbi bazën e shumatores së çmimeve për njësi.*

*Përsa i përket artikullit Nr.56 KSHA sqaron si më poshtë:*

56	<i>N-(1-Naphtyl)ethylenediaminedihydrochloride</i>	<i>C12H14N2x2HCL, Pure</i>	<i>Gram</i>
----	--	----------------------------	-------------

*Përsa i përket artikullit Nr. 73 KSHA sqaron si më poshtë:*

73	<i>MacConkey Broth</i>	<i>Terren per identifikimin e enterokokeve ne je dhe ushqim, pluhur fa agar</i>	<i>Gram</i>
----	------------------------	---	-------------

*Përsa i përket artikullit Nr. 75 KSHA sqaron se klimer agar është terren i përdorur kohë më parë nga specialistët e institucionit tonë. Ekuivalenti i këtij terreni është MacConkey Agar*

75	<i>Klimer/MacConkey agar</i>	<i>Terren diferencues per identifikimin e koliformeve ne ujin e pijshem</i>	<i>Kg</i>
----	------------------------------	---	-----------

[...]

### III

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të pretendimeve të operatorëve ekonomik ankimues, informacionit dhe dokumentacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor,

#### **Arsyeton:**

III.1. Lidhur me pretendimet e ankimuesit për modifikimin e dokumenteve të tenderit, dhe konkretisht për sa i përket kërkesës për sqarim lidhur me faktin nëse vlerësimi i ofertave do të bëhet bazuar në shumatoren e çmimeve për njësi apo bazuar në çmimin total, si dhe lidhur me kërkesën për sqarim lidhur me artikujt me numër rendor nr. 56, nr. 73 dhe nr. 75, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Avdul Gjoni” PERSON FIZIK dhe me vendimin nr. 3306/1 prot., datë 05.12.2023, ka vendosur mos pranimin e ankesës, me arsyetimet si më poshtë vijojnë:

[...]

*Për sa më sipër konstatohet në pikën 1, KSHA sqaron se sipas DST, informacioni i pasqyruar në 2.10 “Përshkrimi i shkurtër i kontratës / Marrëveshjes Kuadër”, të DST dhe informacioni i pasqyruar në 4.4 “Kriteret e përzgjedhjes së fituesit” tregojnë që vlerësimi i ofertave do të bëhet mbi bazën e shumatores së çmimeve për njësi.*

*Përsa i përket artikullit Nr.56 KSHA sqaron si më poshtë:*

56	<i>N-(1-Naphtyl)ethylenediaminedihydrochloride</i>	<i>C12H14N2x2HCL, Pure</i>	<i>Gram</i>
----	--	----------------------------	-------------

*Përsa i përket artikullit Nr. 73 KSHA sqaron si më poshtë:*

73	<i>MacConkey Broth</i>	<i>Terren per identifikimin e enterokokeve ne je dhe ushqim,</i>	<i>Gram</i>
----	------------------------	--	-------------

		<i>pluhur fa agar</i>	
--	--	-----------------------	--

*Përsa i përket artikullit Nr. 75 KSHA sqaron se klimer agar është terren i përdorur kohë më parë nga specialistët e institucionit tonë. Ekuivalenti i këtij terreni është MacConkey Agar*

75	<i>Klimer/MacConkey agar</i>	<i>Terren diferencues per identifikimin e koliformeve ne ujin e pijshem</i>	<i>Kg</i>
----	------------------------------	---	-----------

[...]

III.1.2. Neni 30 i LPP parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarë për procedurat e tjera.*

III.1.3. Neni 115 pika 1 dhe 2 e ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se : *“1. Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:*

*a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:*

*i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;*

*ii. e ankesës/ ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;*

*b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;*

*c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.*

*2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën dhe nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik, brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar dhe vazhdon procedurën për pjesën tjetër.*

Për këtë arsye, KPP do të mbyllë shqyrtimin e çështjes në lidhje me këtë pjesë të pranuar nga autoriteti kontraktor për ankesën me nr. 3047 protokollit me datë 15.12.2023 e operatorit ekonomik “Avdul Gjoni” PERSON FIZIK.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes “Avdul Gjoni” PERSON FIZIK lidhur me afatin e lëvrimit të produkteve objekt-prokurimi, të parashtruara në Ankesën nr. 2, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në pikën 2.11.1 “Kohëzgjatja e Marrëveshjes Kuadër” të dokumenteve të tenderit, autoriteti kontraktor nuk ka përcaktuar afatin e zbatimit të kontratës së prokurimit objekt-ankimi, si më poshtë vijon.

**2.11.1. Kohëzgjatja e Marrëveshjes Kuadër:**

<p><b>Kohëzgjatja në muaj: 12 ose ditë: _____ (nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër)</b></p> <p><i>Ose fillon më _____/_____/_____ (d/m/v)</i></p> <p><i>mbaron më _____/_____/_____ (d/m/v)</i></p>
--

III.2.2. Në Shtojcën 6 “FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT” të dokumenteve të tenderit, autoriteti kontraktor ka përcaktuar sasinë e mallrave objekt-prokurimi dhe afatin e lëvrimit të tyre, si më poshtë vijon.

**Shtojca 6**

**FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT**

*Sasia e mallit që kërkohet:*

<i>Nr .</i>	<i>Artikulli</i>	<i>Specifikime</i>	<i>Njesia</i>	<i>Sasia</i>
1	Acid sulfurik	H2SO4 me pasterti ≥ 95-98%, shisheqelqi ne paketim 1 Lit	Lit	4
2	Acetat Amoni	NH4CH3CO2	gram	500
3	Amphotericine B	Disqe te ngopura, 1 Flakon me 50 disqe	Flakon	10
4	Anti Coli	Tipi 1	Flakon	1
5	Anti Coli	Tipi 2	Flakon	1
6	Anti HCV	Kasete , Test I shpejte imunokromatografik per zbulimin cilesor te antitropave te Hep C ne serum plazemosegjak.	Teste (Cope)	5,000
7	Anti Salmonela	Polivalente	Flakon	3
8	Anti Salmonela	O9	Flakon	3
9	Antigen Brucella melitensis	PlusKontrollpozitiv	Kuti	2
10	Antigen Brucella	PlusKontrollpozitiv	Kuti	

	<i>abortus</i>			2
11	<i>Antigen Paratyphi A</i>	<i>Somatic AO</i>	<i>Flakon</i>	3
12	<i>Antigen Paratyphi A</i>	<i>Flagjelar AH</i>	<i>Flakon</i>	3
13	<i>Antigen Paratyphi B</i>	<i>Somatic BO</i>	<i>Flakon</i>	3
14	<i>Antigen Paratyphi B</i>	<i>Flagjelar BH</i>	<i>Flakon</i>	3
15	<i>Antigen Salmonela</i>	<i>Typhi O</i>	<i>Flakon</i>	3
16	<i>Antigen Salmonela</i>	<i>Typhi H</i>	<i>Flakon</i>	3
17	<i>ASLO kit</i>	<i>Bufer + kontrolle</i>	<i>Kuti</i>	3
18	<i>Bactrine</i>	<i>1 Flakon me antibiotikpermban 50 disqe.</i>	<i>Flakon</i>	50
19	<i>Blood agar</i>	<i>Terrenbaze per pergatitjen e pjatave agar-gjak</i>	<i>Kg</i>	1
20	<i>Ceclor</i>	<i>1 Flakon me antibiotikpermban 50 disqe.</i>	<i>Flakon</i>	50
21	<i>Cefepime</i>	<i>1 Flakon me antibiotikpermban 50 disqe.</i>	<i>Flakon</i>	50
22	<i>Ceftazidim</i>	<i>1 Flakon me antibiotikpermban 50 disqe.</i>	<i>Flakon</i>	50
23	<i>Ceftraxion</i>	<i>1 Flakon me antibiotikpermban 50 disqe.</i>	<i>Flakon</i>	50
24	<i>Cefuroxim</i>	<i>1 Flakon me antibiotikpermban 50 disqe.</i>	<i>Flakon</i>	50
25	<i>Ciprofloxacine</i>	<i>1 Flakon me antibiotikpermban 50 disqe.</i>	<i>Flakon</i>	40
26	<i>Clarithromycin</i>	<i>1 Flakon me antibiotikpermban 50 disqe.</i>	<i>Flakon</i>	40
27	<i>Clotrimazole</i>	<i>Disqetengopura, 1 Flakon me 50 disqe</i>	<i>Flakon</i>	10
28	<i>Cryptosporidium Giardia combi</i>	<i>test rapid</i>	<i>Teste</i>	50
29	<i>DC</i>	<i>Dezoksikolat citrate agar.Iperdorur ne pergatitjen e terreneve selektive per izolimin e bakteve enterike</i>	<i>Kg</i>	10
30	<i>Doxacycline</i>	<i>1 Flakon me antibiotikpermban 50 disqe.</i>	<i>Flakon</i>	40
31	<i>DPD1</i>	<i>Nr.1 tableta per matjen e kloritte lire me limit dedektimi 0.01-6 mg/l, C6H12N2, N,N-diethyl-p-phenylenediamine</i>	<i>Tablet a</i>	10,000

32	<i>Econazoli</i>	<i>Disqetengopura, 1 Flakon me 50 disqe</i>	<i>Flakon</i>	<i>10</i>
33	<i>Ekstraktmishi</i>	<i>Pluhur, ingredient per terrenet e ujit</i>	<i>Gram</i>	<i>500</i>
34	<i>Endo agar</i>	<i>Terren per testet finale dhekonfirmuesete coliforms ne uje</i>	<i>Kg</i>	<i>10</i>
35	<i>Erythromicin</i>	<i>1 Flakon me antibiotikpermban 50 disqe.</i>	<i>Flakon</i>	<i>40</i>
36	<i>Extraktmajaje</i>	<i>Pluhur I perdorur ne pergatitjen e terrenevemikrobiologjike</i>	<i>Gram</i>	<i>200</i>
37	<i>Fluconazole</i>	<i>Disqetengopura, 1 Flakon me 50 disqe</i>	<i>Flakon</i>	<i>10</i>
38	<i>Gentamicin</i>	<i>1 Flakon me antibiotikpermban 50 disqe.</i>	<i>Flakon</i>	<i>50</i>
39	<i>Gonorreja</i>	<i>Rapid test, 1 kuti me 25 cope</i>	<i>Kuti</i>	<i>5</i>
40	<i>HbsAg</i>	<i>Kasete ,Rapid test/Test I shpejteimunokromatografik per percaktimin e antigenitsiperfaqesortehepatitit B ne serum oseplazma. .</i>	<i>Teste (Cope)</i>	<i>7,000</i>
41	<i>Hidroksid amoni</i>	<i>NH4OH, Pure</i>	<i>Lit</i>	<i>1</i>
42	<i>HIV1&amp;HIV2</i>	<i>Kasete ,Rapid test/Test I shpejteimunokromatografik per zbulimin e antitrupavete HIV1&amp;HIV2 ne gjakdhe ne serum. ..</i>	<i>Teste (Cope)</i>	<i>6,000</i>
43	<i>Imipenem</i>	<i>1 Flakon me antibiotikpermban 50 disqe.</i>	<i>Flakon</i>	<i>40</i>
44	<i>Itraconazole</i>	<i>Disqetengopura, 1 Flakon me 50 disqe</i>	<i>Flakon</i>	<i>10</i>
45	<i>Ketokonazole</i>	<i>Disqetengopura, 1 Flakon me 50 disqe</i>	<i>Flakon</i>	<i>10</i>
46	<i>KIA</i>	<i>Pluhur per percaktimin e baktereveenterite</i>	<i>Gram</i>	<i>500</i>
47	<i>Kite fece gjak okult</i>	<i>test rapid</i>	<i>Teste</i>	<i>2,200</i>
48	<i>Kite fece Helicobakter Pylori</i>	<i>test rapid</i>	<i>Teste</i>	<i>2,000</i>
49	<i>Klamidia</i>	<i>Rapid test, 1 kuti me 30 cope</i>	<i>Kuti</i>	<i>4</i>
50	<i>Kontroll polivalent pozitive</i>	<i>Per antigenet febrile te salmoneles</i>	<i>Flakon</i>	<i>2</i>
51	<i>Meropenem</i>	<i>1 Flakon me antibiotik permban 50 disqe.</i>	<i>Flakon</i>	<i>40</i>
52	<i>Miconasole</i>	<i>Disqetengopura, 1 Flakon me 50 disqe</i>	<i>Flakon</i>	<i>10</i>
53	<i>Myllerhinton</i>	<i>Pluhur, ngjyre bezhe i perdorur ne pergatitjen e terreneve mikrobiologjike,tretet mire ne uje</i>	<i>Kg</i>	<i>3.5</i>



54	<i>Nessler</i>	<i>Paketim 1 lit, Pure</i>	<i>Lit</i>	7
55	<i>Nitrofurantoin</i>	<i>1 Flakon me antibiotik permban 50 disqe.</i>	<i>Flakon</i>	50
56	<i>N-naftiletildiamin</i>	<i>C12H14N2, Pure</i>	<i>Gram</i>	80
57	<i>Nystatin</i>	<i>Disqe te ngopura per mycograme,1 Flakon me 50 disqe</i>	<i>Flakon</i>	10
58	<i>Ox19</i>	<i>Antigen Ox19 per Rikecia</i>	<i>Flakon</i>	1
59	<i>Penicilline</i>	<i>1 Flakon me antibiotikpermban 50 disqe.</i>	<i>Flakon</i>	40
60	<i>Rose Bengal test</i>	<i>Plus kontroll</i>	<i>Kuti</i>	1
61	<i>Saburo agar</i>	<i>Pluhur per percaktimin e mykut</i>	<i>Kg</i>	4
62	<i>Shigele Flexner</i>	<i>serum</i>	<i>Flakon</i>	2
63	<i>Shigele Boydi</i>	<i>serum</i>	<i>Flakon</i>	2
64	<i>Shigele Polivalente</i>	<i>Serum antigenic i cili vërteton shigelen (e ndan nga te tjerat)</i>	<i>Flakon</i>	2
65	<i>Shigele Sonei</i>	<i>serum</i>	<i>Flakon</i>	2
66	<i>Staphylococcus test</i>	<i>Rapid test per specifikimin e Staphylococcus, paketimi 1 kuti/2 flakon</i>	<i>Kuti</i>	3
67	<i>Stereptococcus test</i>	<i>Rapid test per specifikimin e Stereptococcus, strep groupong rapid latex test kit</i>	<i>Kuti</i>	2
68	<i>Sulfanil amid</i>	<i>C6H8N2O2S, Pure</i>	<i>Gram</i>	100
69	<i>SulfatZinku</i>	<i>ZnSO4, paketimi 1 kuti/ 1 kg</i>	<i>kuti</i>	20
70	<i>Syphilis</i>	<i>Kasete , Test I shpejteimunokromatografik per percaktimin e syphilis .</i>	<i>Teste (Cope)</i>	6,200
71	<i>Tobramicine</i>	<i>1 Flakon me antibiotikpermban 50 disqe.</i>	<i>Flakon</i>	40
72	<i>Tuba me xhel</i>	<i>Tuba me xhel per marrjen e gjakut, tuba 5 ml pa llogaritur xhelin ose 7 ml duke llogaritur xhelin</i>	<i>cope</i>	9,000
73	<i>MacConkey</i>	<i>Terren I lengshem per identifikimin e enterokokeve ne uje dhe ushqim</i>	<i>kg</i>	20
74	<i>XLD agar</i>	<i>Terren per izolimin dhe diferencimin e bacileve gram negativ</i>	<i>gram</i>	500
75	<i>Klimer agar</i>	<i>Terren diferencues per identifikimin e</i>	<i>kg</i>	0.5

		<i>koliformeve ne ujin e pijshem</i>		
76	<i>EC Medium me MUG(4-methylumbelliferyl-β-D-glucuronide)</i>	<i>Terren per dedektimin e E-Coli ne uje dhe ushqime</i>	<i>kg</i>	<i>0.5</i>
77	<i>Jodur kaliumi</i>	<i>Potassium Iodide, rapid test per percaktimin e jodurit te kaliumit ne kripe</i>	<i>Flakon</i>	<i>25</i>
78	<i>Jodat kaliumi</i>	<i>Potassium Iodate, rapid test per percaktimin e jodatit te kaliumit ne kripe</i>	<i>Flakon</i>	<i>25</i>

- **Kontratat do te jepen brenda periudhës:** nga momenti i lidhjes se Marrëveshjes Kuadër me Operatorin ekonomik të shpallur fitues, me afat përfundimtar 12 muaj nga data e nënshkrimit të MK.

**Afatet e lëvrim:**

**Për cdo kontratë të lidhur sipas përcaktimit më sipër afatet e lëvrim do të jenë si më poshtë:**

- 40% e mallit për materialet kite, reagentë, konsumabël etj., duhet të lëvrohet maksimumi brenda 30 ditëve pas nënshkrimit të kontratës
- pjesa tjetër sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor

III.2.2. Në procesverbalin e “PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM” të publikuar në SPE nga ana e autoritetit kontraktor lidhur me afatin e zbatimit të kontratës objekt-prokurimi, nga ana e autoritetit kontraktor është argumentuar përcaktimi i afatit të produkteve objekti kontratës, si në vijim: **“Argumentimi:** Sasia dhe Grafiku i levrimit jane vendosur ne baze te relacionit për argumentimin e fondit limit si dhe hartimin e specifikimeve teknike me nr. 3054/5 prot.,date 21/11/2023, si dhene perputhje me piken 3, germa b te nenit 15 te VKM nr. 285, datë 19.05.2021, **“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, te ndryshuar.”.**

III.2.3. Referuar Neni 2 i ligjit 162/2021 “Për Prokurimin Publik” parashikon shprehimisht se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë eficientën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.

Neni 3, “Parime të përgjithshme” i ligjit 162/2021 “Për Prokurimin Publik” parashikon shprehimisht se:

1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe vepronë me transparencë e në 5 mënyrë proporcionale.
2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

Neni 21 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2021 “Për Prokurimin Publik” parashikon shprehimisht se: *Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.*

Në nenin 77 te ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

*“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

III.2.4. Në nenin 74 të ligjit 162/2021 “Për Prokurimin Publik” parashikon shprehimisht se:

*“1. Autoriteti ose enti kontraktor, në hartimin e dokumenteve të tenderit, përdor dokumentet standarde, sipas përcaktimit në rregullat e prokurimit publik dhe i vë në dispozicion falas në rrugë elektronike.”.*

III.2.5. Në nenin 14 të Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

*“1. APP-ja harton dhe miraton me vendim formatin e dokumenteve standarde të tenderit që do të përdoren gjatë procedurave të prokurimit, për çdo lloj procedure prokurimi sipas nenit 41, të LPP-së, dhe çdo tip kontrate.”.*

III.2.6. Me Vendimin nr. 3, datë 09.06.2021 “Miratimin e dokumenteve standarde të tenderit për mallra, punë, shërbime për procedurën e prokurimit ‘Procedurë e Hapur e Thjeshtuar’ ”, i

ndryshuar, Agjencia e Prokurimit Publik ka miratuar dokumentet standarde të tenderit për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar – mallra”, ku në 2.11 “Kohëzgjatja e kontratës ose afati i zbatimit të kontratës” të Seksionit 2 “Objekti i Kontratës” dhe Shtojcën 6 “FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT” përcaktohet si më poshtë vijon:

**2.11.1. Kohëzgjatja e Marrëveshjes Kuadër:**

<b>Kohëzgjatja në muaj: ____ ose ditë: ____ (nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër</b>	
Ose fillon më	____/____/____ (d/m/v)
mbaron më	____/____/____ (d/m/v)

**Shtojca 6**

*(Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)*

*(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)*

**FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT**

*Sasia e mallit që kërkohet:*

**Afatet e lëvrimit:**

Artikulli	Përshkrimi	Shuma	Destinacioni	Periudha e dorëzimit

III.2.7. Lidhur me pretendimin e mësipërm të operatorit ekonomik ankimues “Avdul Gjoni” PERSON FIZIK, autoriteti kontraktor në kthimin e përgjigjes nr. 3306/1 prot., datë 05.12.2023, drejtuar ankimuesit është shprehur se: “[...] Për sa më sipër konstatohet në pikën 2, KSHA sqaron se Sasia dhe Grafiku i lëvrimit janë vendosur në përputhje me pikën 1 të nenit 40 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në të cilën gjejmë të përcaktuar se: “1. Në procedurat e prokurimit për mallra, autoriteti/enti kontraktor parashikon sasinë e mallrave që do të lëvrojë, si dhe grafikun e lëvrimit të mallrave. Përsa i përket pikës së parë në të cilën është vendosur lëvrimi i mallit brenda 30 ditëve pas lidhjes së kontratës duke u bazuar dhe në kontrata që institucioni jonë ka pasur vit pas viti me operator ekonomik të suksesshëm ku konkretisht në vitin 2022 afati ka qënë 20 ditë dhe është realizuar brenda afatit kohor të caktuar.

Gjithashtu theksojmë që procedura është 12 mujore dhe produktet Kite reagent të cilat prokurohen nevojiten në kohë sa më të shpejtë për arsye se Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësore Tiranë, kryesisht ofron aktivitetin e saj e ka të përqëndruar te bërja e analizave për

*një ofrim shendetësore sa më të mirë për qytetarët. Përsa i përket pikës së dytë sqarohet se është e kuptueshme që pjesa tjetër sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor do të jetë brenda 30 ditëve sikundër është përcaktuar atëherë në pikën e parë.*

*Për këtë arsye, KSHA vlerëson se pretendimi i ngritur nga OE për pikën 2 nuk qëndron.... [...]”, duke mos pranuar pretendimin e operatorit ekonomik ankimes, si dhe duke dhënë argumentet për këtë mospranim.*

III.2.8. Komisioni i Prokurimit Publik, referuar legjislacionit vëren se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim, gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, bazuar në legjislacionin për prokurimin publik duke mos i tejkaluar kompetencat që parashikon në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik.

Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, se kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik, në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura.

Akoma më tej referuar objektin e prokurimit, sasisë së produkteve që do të lëvrohen, Autoriteti Kontraktor duhet të mirëargumentojë afatin e zbatimit të kontratës objekt-prokurimi, duke pasur parasysh parimin e proporcionalitetit.

Referuar pretendimit të ankimesit në lidhje me afatin e zbatimit të kontratës, si edhe referuar argumenteve të autoritetit kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se afati i përcaktuar në Shtojcën 6 të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, nuk është i mjaftueshëm për realizimin në kohë të objektit të prokurimit, duke iu referuar sasisë dhe grafikut të lëvrimin të mallrave të përcaktuara në këtë shtojcë.

Gjithashtu, Autoriteti Kontraktor në argumentet në lidhje me këtë pikë të ankesës, trajtuar në vendimin e KSHA-së nuk është bindës në vendimin e tij për mosndryshim të afatit të lëvrimin të mallit.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të modifikojë afatin e zbatimit të kontratës sipas pretendimit të ankimesit, si dhe duhet të ketë parasysh dhe kohën e pamjaftueshme që i duhet operatorëve ekonomikë (fitues të mundshëm të procedurës së prokurimit) për të siguruar dhe ilëvruarmallin e kërkuar në përputhje me specifikimet teknike të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

Referuar arsyetimit të mësipërm, Autoriteti Kontraktor duhet të rishikojë afatet e lëvrimin të mallit duke i ndryshuar ato.

Për sa më sipër, kërkesa e operatorit ekonomik qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Avdul Gjoni” PERSON FIZIK lidhur me modifikimin e kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.a të Shtojcës 7 “*FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*” të dokumentave të tenderit, të parashtruara në Ankesën nr. 3, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në Seksionin 4: “*Procedura*”, pika 4.1 “*Lloji i procedurës*” të dokumentave të tenderit, autoriteti kontraktor ka përcaktuar llojin e procedurës së prokurimit, si më poshtë vijon:

#### **“Seksioni 4: Procedura**

##### ***4.1 Lloji i procedurës: Procedure e Hapur, e Thjeshtuar”.***

III.3.2. Në pikën 2.3.a të Shtojcës 7 “*FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*” të dokumentave të tenderit, autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin kualifikues, si më poshtë vijon.

***“2.3.a. Operatori ekonomik duhet te paraqese dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të kryera gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes të njoftimit të kontratës, me një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet.***

- ***Si dëshmi për përvojën e mëparshme me nje ent publik, kërkohen vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.***
- ***Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.***

***Shënim\*:*** Për efekt të përlogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, 40% do te aplikohet mbi vlerën e fondit limit të parashikuar për këtë procedurë prokurimi, ***konkretisht mbi vlerat e kolonës “Vlera e pritshme e kontratave” ne piken 2.10.”.***

III.3.3. Në procesverbalin e “*PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM*” të publikuar në SPE nga ana e autoritetit kontraktor lidhur me afatin e zbatimit të kontratës objekt-prokurimi, nga ana e autoritetit kontraktor është argumentuar përcaktimi i afatit të produkteve objekti kontratës, si në vijim: ***“Argumentimi:*** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “*Për prokurimin publik*”, nenit 40/4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

*Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:  
Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 40 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.”.*

III.3.4. Në nenin 40, pika 4 të Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

*“4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre vjetëve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre vjetëve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*

*Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*

*Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.”.*

Ndërsa në nenin 55, pika 4 të Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

*“4. Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kritere të thjeshtuara pranimi, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm.*

*Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkojnë në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave.*

*Lidhur me kërkesat për përvojën e ngjashme, vlera e kërkuar në procedurat e thjeshtuara duhet të jetë:*

*a) Për kontratat e punëve: i. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 30% e vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë vjetëve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. ii. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë*

*pesë vjetëve të fundit, është jo më e madhe se vlera limit e kontratës ose lotit që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.*

*b) Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre vjetëve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.” .*

III.3.5. Lidhur me pretendimin e mësipërm të operatorit ekonomik ankimues “Avdul Gjoni” PERSON FIZIK, autoriteti kontraktor në kthimin e përgjigjes nr. 3306/1 prot., datë 05.12.2023, drejtuar ankimuesit është shprehur se: “[...] Për sa më sipër bazuar në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, neni 55, pika 4/b në të cilën citohet se... Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës..... KSHA konstaton se në pikën 2.3 Kapaciteti teknik të DST, duhet të bëhet ndryshimi si më poshtë:

*Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të kryera gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes të njoftimit të kontratës, me një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet.*

- *Si dëshmi për përvojën e mëparshme me një ent publik, kërkohen **vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.***
- *Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm **fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.***

*Shënim\*: Për efekt të përllogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, 40% do të aplikohet mbi vlerën e fondit limit të parashikuar për këtë procedurë prokurimi, konkretisht mbi vlerat e kolonës “Vlera e pritshme e kontratave” në pikën 2.10.”.*

*Ky sqarim duhet të pasqyrohet në DST nëpërmjet hartimit të një shtojce në mënyrë që të njihen OE ofertues.*

*Pretendimi i operatorit ekonomik për ta modifikuar kriterin sipas nenit 40, pika 4 nuk qëndron [...]], duke mos pranuar pretendimin e operatorit ekonomik ankimues, si dhe duke dhënë argumentet për këtë mospranim.*

III.3.6. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e



rëndësishme të provohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit zotërojnë kapacitetin teknik e konkretisht dëshmi për përvojën e mëparshme. Autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit. Dokumentet e tenderit dhe kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura, për realizimin me sukses të kontratës me qëllim zgjerimin e rrethit të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në respekt të nenit 2 të LPP-së. Lidhur me pretendimin e mësipërm të ankimuesit ndonëse autoriteti kontraktor me të drejtë ka vendosur të modifikojë kriterin kualifikues sipas përcaktimit të nenit 55, pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se autoriteti kontraktor duhet të bëjë modifikimin e kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.a të Shtojcës 7 të dokumentave të tenderit, duke riformuluar kriterin kualifikues lidhur me vlerën e furnizimeve të ngjashme të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, sipas përcaktimeve të kësaj dispozite.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron pjesërisht.

III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues "*Avdul Gjoni*" PERSON FIZIK lidhur me modifikimin e kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.c të Shtojcës 7 "*FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*" të dokumentave të tenderit, të parashtruara në Ankesën nr. 4, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.4.1. Në pikën 2.3.c të Shtojcës 7 "*FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*" të dokumentave të tenderit, autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin kualifikues, si më poshtë vijon.

*"2.3.c. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqese Autorizim të leshuar nga Prodhuesi / MAH / Distributori Zyrtar i Autorizuar (ku të provohet /dokumentohet lidhja e tyre me prodhuesin) nëpërmjet të cilit konfirmohet se autorizohet të tregtoje mallrat (materiale të mjekësore) objekt prokurimi. Autorizimi duhet të jete i vlefshem në momentin e hapjes dhe dorëzimit të ofertave.*

*Shënim: Kriterin e mësipërm, ofertuesit mund ta përmbushin edhe në formë vetëdeklarimi, me kusht që në rastin e renditjes i pari, me njoftimin e paraqitjes së dokumentacionit pranë AK dhe përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentet provuese për deklarimin e bërë. Mosparaqitja e këtij dokumentacioni përbën kusht për skualifikimin e ofertës së paraqitur. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin."*

III.4.2. Në procesverbalin e "*PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM*" të publikuar në SPE nga ana e autoritetit

kontraktor lidhur me afatin e zbatimit të kontratës objekt-prokurimi, nga ana e autoritetit kontraktor është argumentuar përcaktimi i afatit të produkteve objekti kontratës, si në vijim: **“Argumentimi:** Ky kriter vendos ne mbeshtetje te praktikës së suksesshme të ndjekur në vite nga AK,. Gjithashtu ky kriter gjen mbeshtetje ne pikat 2 dhe 4 te nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 5 te nenit 44 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ku eshte e ciftuar: 5. Kur është e dukshme që një operator ekonomik e ka të pamundur të marrë etiketën specifike, të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor ose një etiketë ekuivalente, brenda afateve kohore përkatëse, për shkaqe që nuk lidhen me atë operator ekonomik, autoriteti ose enti kontraktor pranon mënyra të tjera vërtetimi të përshtatshme, që mund të përfshijnë një dosje teknike nga prodhuesi, nëse operatori ekonomik në fjalë vërteton se punët, furnizimet ose shërbimet që ai duhet të ofrojë përmbushin kërkesat e etiketës specifike ose kërkesat specifike të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor., si dhe pikën 8 të nenit 40 ‘Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave’ ku parashikohet se: 8. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

Autorizimi per OE ofertues nga firma prodhuese ose nga distributori i autorizuar prej prodhuesit është një dokument i domosdoshëm për t’u paraqitur, në mënyrë që autoriteti kontraktor të sigurohet që subjekti/shoqëria që disponon këtë dokument, autorizon operatorin ekonomik që ta furnizojë me produktet e tij; Domosdoshmëria e tij lidhet me garancinë e mallit të cilën e jep prodhuesi dhe jo operatori ekonomik ofertues (ref. Vendimit te KPP nr. 353/2014). Si dhe gjithashtu ky kriter u vendos ne mbeshtetje te Rekomandimit nr. 3341/1 prot. Date 20.03.2018 te Agjensise se Prokurimit Publik (Drejtoria Juridike dhe Monitorimit) drejtuar Autoriteteve Kontraktore “Rekomandim mbi hartimin e kritereve per kualifikim ne dokumentet e tenderit te procedurave te prokurimit publik”. AK ka parashikuar formën deklarative të autorizimit në këtë procedurë prokurimi në momentin e ofertimit në mënyrë që të respektojë parimet e legjislacionit të prokurimit publik. Përpara lidhje se kontratës OE i renditur i pari ka detyrimin të provojë këtë deklaram, duke paraqitur autorizimin e firmës prodhuese/MAH/distributorit zyrtar të autorizuar nga prodhuesi, duke garantuar në këtë mënyrë, aftësinë për të zbatuar kontratën në kohë dhe me cilësi.”.

III.4.3. Referuar Neni 2 i ligjit 162/2021 “Për Prokurimin Publik” parashikon shprehimisht se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.

Neni 3, “Parime të përgjithshme” i ligjit 162/2021 “Për Prokurimin Publik” parashikon shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në 5 mënyrë proporcionale.*
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.*

Neni 21 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2021 “Për Prokurimin Publik” parashikon shprehimisht se: *“Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.”.*

Në nenin 26, pika 2, të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

*“2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon:*

- a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit dhe ka statusin aktiv;*
- b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;*
- c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionarit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;*
- ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;*
- d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;*
- dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;*
- e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;*
- ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;*

- f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;
- g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;
- h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);
- i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;
- j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;
- k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.”.

Në nenin 77, pika 1 dhe 4 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoje që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

III.4.4. Në nenin 40, pika 8 të Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“8. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”.

III.4.5. Lidhur me pretendimin e mësipërm të operatorit ekonomik ankimues “Avdul Gjoni” PERSON FIZIK, autoriteti kontraktor në kthimin e përgjigjes nr. 3306/1 prot., datë 05.12.2023,

drejtuar ankimuesit është shprehur se: “[...] Përsa më sipër konstatohet në pikën 4, KSHA sqaron se ky kriter vendos në mbështetje të praktikës së suksesshme të ndjekur në vite nga AK. Gjithashtu ky kriter gjen mbështetje në pikat 2 dhe 4 të nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe pikën 5 të nenit 44 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", ku është e cituara: 5. Kur është e dukshme që një operator ekonomik e ka të pamundur të marrë etiketën specifike, të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor ose një etikete ekuivalente, brenda afateve kohore përkatëse, për shkaqe që nuk lidhen me atë operator ekonomik, autoriteti ose enti kontraktor pranon mënyra të tjera vërtetimi të përshtatshme, që mund të përfshijnë një dosje teknike nga prodhuesi, nëse operatori ekonomik në fjalë vërteton se punët, furnizimet ose shërbimet që ai duhet të ofrojë përmbushin kërkesat e etiketës specifike ose kërkesat specifike të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor., si dhe pikën 8 të nenit 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” ku parashikohet se: 8. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

Autorizimi për OE ofertues nga firma prodhuese ose nga distributori i autorizuar prej prodhuesit është një dokument i domosdoshëm për tu paraqitur, në mënyrë që autoriteti kontraktor të sigurohet që subjekti/shoqëria që disponon këtë dokument, autorizon operatorin ekonomik që ta furnizojë me produktet e tij; Domosdoshmëria e tij lidhet me garancinë e mallit të cilën e jep prodhuesi dhe jo operatori ekonomik ofertues(ref. Vendimit të KPP nr. 353/2014). Si dhe gjithashtu ky kriter u vendos në mbështetje të Rekomandimit nr. 3341/1 prot. Date 20.03.2018 të Agjensisë së Prokurimit Publik (Drejtoria Juridike dhe Monitorimit) drejtuar Autoriteteve Kontraktore “Rekomandim mbi hartimin e kritereve për kualifikim në dokumentet e tenderit të procedurave të prokurimit publik”. AK ka parashikuar formën deklarative të autorizimit në këtë procedurë prokurimi në momentin e ofertimit në mënyrë që të respektojë parimet e legjislacionit të prokurimit publik. Përpara lidhje së kontratës OE i renditur i pari ka detyrimin të provojë këtë deklaram, duke paraqitur autorizimin e firmës prodhuese/MAH/distributorit zyrtar të autorizuar nga prodhuesi, duke garantuar në këtë mënyrë aftësinë për të zbatuar kontratën në kohë dhe me cilësi.

*Për këtë arsye, KSHA vlerëson se pretendimi i ngritur nga OE për pikën 4 nuk qëndron.”.*

III.4.6. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit zotërojnë kapacitetin teknik e konkretisht dëshmi që vërtetojnë se ka aftësinë për të siguruar nga prodhuesi apo distributori i autorizuar nga prodhuesi produktet objekt-prokurimi. Autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kritereve të veçanta për kualifikim është lënë

nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit. Dokumentet e tenderit dhe kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura, për realizimin me sukses të kontratës me qëllim zgjerimin e rrethit të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në respekt të nenit 2 të LPP-së.

Përsa i përket kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.c të Shtojcës 7 të dokumentave të tenderit, Komisioni konstaton se autoriteti kontraktor për plotësimin e këtij kriteri ka përcaktuar që ofertuesit duhet ta paraqesin në formën e një deklarimi paraprak dhe operatori ekonomik ofertues i renditur i pari duhet të paraqesë dokumentacionin e deklaruar e konkretisht autorizimin e prodhuesit ose autorizimin e nga distributori i autorizuar dhe lidhjen e këtij të fundit me prodhuesin, ndërkohë që vetedeklarimi është parashikuar në nenin 26 të LPP-së dhe gjen vetëm për informacione dhe deklarime specifike të përcaktuara në këtë nen, ku nuk përfshihet deklarimi për autorizimin nga prodhuesi apo distributori i autorizuar nga prodhuesi.

Lidhur me pretendimin e mësipërm të ankimuesit, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se autoriteti kontraktor duhet të bëjë modifikimin e kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.c të Shtojcës 7 të dokumentave të tenderit, duke riformuluar kriterin kualifikues lidhur me dokumentacionin që duhet të paraqesin ofertuesit për plotësimin e këtij kriteri kualifikues, duke hequr përcaktimin në formën e një vetëdeklarimi dhe duke përcaktuar paraqitjen e dokumentacionit konkret për plotësimin e këtij kriteri kualifikues.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në 10 një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19” Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

## Vendosi

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Avdul Gjoni” PERSON FIZIK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur, e Thjeshtuar*”, me Nr. REF-89520-12-04-2023, me objekt: “*Blerje Kite dhe Reagentë, për nevojat e NJVKSH Tiranë*”, me fond

limit 7.992.867 lekë pa TVSH, parashikuar për t'u zhvilluar më datë 15.12.2023 nga autoriteti kontraktor, Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Tiranë.

2. Autoriteti kontraktor të bëjë modifikimet e të dokumenteve të tenderit në SPE, sipas konstatimeve të Komisionit të Prokurimit Publik.
  3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të verë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
  4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik "Avdul Gjoni" PERSON FIZIK.
  5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**